



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

01-1704



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21, 44 dhe 79 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr. 05/L -031, dt.21.06.2016, nenit 17 pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, dhe nenit 15 pika “d” të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01nr.110-391, dt.25.02.2010, Udhëzimit Administrativ 06/2017 dt. 23.05.2017 të MMPH-së, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 nr.350/02 – 209559/23 dt. 23.10.2023, të aplikuesit Bashkim dhe Mervete Kelmendi nga Prishtina, për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr. 350/05-57902/22 dt. 27.10.2022, për ndërtimin e ndërtesës individuale banimore/shtëpi familjare, në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia/ 2016-2024”, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 21.10.2024 merr këtë:

V E N D I M

PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË
AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE” TË NDËRTESESË
INDIVIDUALE BANIMORE / SHTËPISË FAMILJARE, ME REFERENCË 05 NR. 350/02-57902/22 DT.
27.10.2022

I. I VAZHDOHET afati i vlefshmërisë, Vendimit të kushteve ndërtimore 05 Nr.350/02-57902/22 dt.27.10.2022, lëshuar nga kjo drejtori, në emër të kërkuesve: Bashkim dhe Mervete Kelmendi, me adresë në Rr. Dr.Shpëtim Robaj,pn./, në Prishtinë, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës /shtëpisë individuale banimore, me etazhitet B+P+1, në kuadër të bllokut urban "C-09", të tërësisë urbane “C”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia/ 2016-2024”, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 00055-13, ZK Prishtinë.

II. Afati i vlefshmërisë të vendimit të kushteve ndërtimore nga paragrafi I. i këtij vendimi është një (1) vit, dhe i njëjti do të prodhojë efekte juridike nga dita e njoftimit të palës me këtë akt.

A r s y e t i m

Aplikuesit Bashkim dhe Mervete Kelmendi, me adresë në Rr. Dr. Shpëtim Robaj,pn./, në Prishtinë, me kërkesën 05 nr.350/02 – 209559/23 dt. 23.10.2023, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, të ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, me referencë 05 Nr.350/02-57902/22 dt.27.10.2022, të përshkruar si në paragrafin I të dispozitivit të këtij Vendimi.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar: Fotokopjen e pa vërtetuar të Vendim të kushteve ndërtimore, 05 Nr.350/02-57902/22 dt.27.10.2022, kopje e mjetit identifikues të Bashkim dhe Mervete Kelmendi.

Drejtorja e Urbanizmit, pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të bashkëngjitur, konsultimit të dosjes së lëndës 05Nr. 350/02-57902/22 dt. 05.03.2022, dhe të rregullativës ligjore në fuqi, nga aspekti i procedurës së përgjithshme administrative, konstatoi se: Bazuar në dosjen e lëndës së lartcekur, konstatohet se Vendimi i kushteve ndërtimore 05 Nr.350/02-57902/22 dt.27.10.2022, ka filluar prodhimin e pasojës juridike nga data e njoftimit të kërkuesit me aktin administrativ, gjegjësisht me dt.16.11.2022, kurse kërkesa për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë është parashtuar me

Faqe 1 prej 2

dt.23.10.2023, e që është brenda afatit dhe në harmoni me pikën 8, të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve.

Bazuar në paragrafin X. të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore 05 Nr.350/02-57902/22 dt.27.10.2022, thuhet se poseduesi i kushteve ndërtimore është i obliguar që, citoj: “Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë”, dhe në pikën 8, të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, ku thuhet se, citojmë: “Gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kushteve Ndërtimore, organi kompetent mundet, me kërkesë të poseduesit të Kushteve Ndërtimore, të vazhdojë periudhën e vlefshmërisë vetëm edhe për një (1) vit.” në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor.

Andaj, bazuar në konstatimin e përshkruar më lartë dhe bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, u konstatua se vazhdimi i afatit të vlefshmërisë është i bazuar dhe ligjor dhe kjo drejtori të njëjtën vendosi ta vazhdoj edhe për një (1) vit tjetër, përmes këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror - MMPHI-Departamenti Ligjor i MMPH-së.

Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesit, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndëve 05Nr. 350/02-57902/22 dt. 05.03.2022; 05 nr.350/02 – 209559/23 dt. 23.10.2023, dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-209559/23 DT.21.10.2024**

Zyrtare,
Bahtie Uka



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazifë Krasniqi

